

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e –IV-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
18 maj 2018 në sallën e Kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Nezir Klinaku, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, dhe Lutfi Bilalli (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Rrezarta Krasniqi.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Miran Halili, Berat Sadiku, Fatmire Cecelia, Mehmet Selaci), Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore, nga sekretaria e kuvendit: Batri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekzistonte shumica e mjaftueshme për punë.

Ai theksoi se kanë ardhur disa propozime që të futen në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren buxhetore 2019;
- Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e parkut industrial në fshatin Lumadh;
- Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Ismail Istrefi.

Nezir Klinaku dhe Shpëtim Zhegrova propozuan që pikat: 6,7 dhe 8 të mbesin vetëm një pikë për shkak të natyrës së njëjtë të kësaj çështjeje.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – deklaroi se nuk ka arsye që të shtyhet propozim-vendimi për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave, pasi që si material nuk na ka ardhur për t'u shqyrtuar në këtë mbledhje. Haradinaj theksoi se jemi në muajin maj dhe se ky propozim-vendim duhet të përgatitet për këtë seancë të kuvendit, në mënyrë që ndarja e mirënjohjeve të jepet për Ditën e Çlirimit (17 qershor).

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – tha se pak më herët e përfundoi Propozim-vendimin për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave dhe kërkoj që të futet në rend të ditës për shqyrtim.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – propozoi që informata lidhur me qarkoren buxhetore të zhvendoset si pikë e dytë e rendit të ditës, për shkak të rëndësisë së saj.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 16.04.2018;
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren buxhetore 2019;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrisë;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për riemërtimin e rrugës “Hasan Tiku Shabani” në emrin e rrugës së propozuar “Dëshmorët e Oshlanit” në Vushtrri;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për renditjen në <listën e emrave rezervë të rrugëve>, emrat e propozuar si në vijim: “Liman Bajram Hasani”, “Haradin Liman Hasani”, “Selman Liman Hasani”, “Ali Jakupi” dhe “Enver Morina”;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr. 49/17 të datës 23.02.2017.
8. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin të parkut industrial në fshatin Lumadh;
 - b. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Ismail Istrefi;
 - c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 16.04.2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren buxhetore 2019.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – i njoftoi të pranishmit se buxheti për vitin 2019 do të jetë 19,519,355.00 € ose 1, 565,420.00 € më i madh se vitin e kaluar.

Ndërkaq, granti i përgjithshëm është më i vogël për 93,000.00 €, kurse, granti për arsim është më i lartë se vitin e kaluar, tha ai.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se të hyrat vetanake me qarkoren e vjetër kanë qenë të parapara që të zbriten për vitin 2018, kurse tash po e shohim që ka ngritje për të hyrat vetanake. Zhegrova tha që në vitet paraprake kanë bërë disa herë kërkesa të vazhdueshme në qeveri që të ngritet granti i përgjithshëm dhe të ulen të hyrat vetanake. Mirëpo, nuk janë marrë parasysh asnjëherë, u shpreh Zhegrova. Sipas tij, do të

ishte mirë që si KPF dhe si kuvend të kërkohet nga Qeveria rritja e grantit të përgjithshëm dhe zvogëlimi i të hyrave vetanake.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se në faqen 3 gjenden disa gabime teknike dhe kërkoi që për kuvend të përmirësohen.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – kërkoi informacione nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me ndarjen e mjeteve për klubet sportive. Pra, deri ku ka shkuar procedura dhe se pse nuk janë ndarë deri më tani këto mjete, u shpreh Zhegrova, i cili shtoi se klubet gjenden në përfundim të sezonit dhe një pjesë e madhe e klubeve po ballafaqohen me një gjendje të keqe financiare.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – deklaroi se komisioni është duke punuar dhe se shumë shpejtë do të ndahen mjetet për klubet sportive. Ajo tha se vonesa ka ndodhur për shkak të ndryshimit të procedurës për aplikim, pasi që tash është bërë me thirrje për aplikim, sipas rregullores së Ministrisë së Financave.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se në të ardhmën duhet të mendojmë që ta rrisim numrin e bibliotekave nëpër shkollat që gjenden nëpër fshatra apo nëpër bashkësi lokale, qysh ka qenë përpara. Ai tha se mirë do të ishte të mendohet që të bëhet një bibliotekë në bashkësinë lokale –Stanoc i Epërm (ku përfshihen fshatrat: Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm, Lumadh dhe Gracë), pasi që është në plan të ndërtohet shkolla e re dhe do të ishte e nevojshme biblioteka, tha ai. Po ashtu, edhe në fshatrat e Çyçavicës të bëhet biblioteka në shkollë, në mënyrë që nxënësit për një libër mos të kenë nevojë që të vijnë në qytet, deklaroi Haradinaj.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e KPF-së – theksoi se tek aktivitetet e bibliotekës, më mirë është që të paraqitet pjesëmarrja e qytetarëve jashtë komunës, e jo e pjesëmarrësve të zyrtarëve komunalë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.

Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – deklaroi se me stafin që kemi dhe me mekanizmat që posedojmë është shumë e vështirë të punohet më shumë për mbrojtjen e pyjeve. Ai tha se kemi kërkuar si drejtor që ta kemi në dispozicion një traktor për bartjen e drunjve të konfiskuar. Ai tha se shkolla e mesme

profesionale e posedon një traktor dhe do të ishte ndihmesë për neve që ta shfrytëzojmë për rastet e konfiskimit të drunjve, tha Halili.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se çështja e mbrojtjes së pyjeve është kompetencë e deleguar, e cila është e vështirë të realizohet nga komuna. Çështja e traktorit të shkollës nuk është zgjidhje, sepse është pronë e tyre dhe mund të lihen keq, tha Tahiri. Sipas tij, kjo çështje është diskutuar edhe në asociacionin e komunave dhe rojet e pyjeve shumë shpejt do të bëhen pjesë e agjencionit, ashtu qysh ka qenë më herët. Sipas Tahirit, Agjencioni Pyjor i Kosovës ua ka lënë mundësinë komunave që t'i angazhojnë disa roje të pyjeve, mirëpo as buxhet të përhershëm nuk kemi për këto roje dhe i angazhojmë me kontratë për shërbime të veçanta. Nëse nuk na ndihmon qeveria në këtë drejtim, pra agjencia dhe nuk e merr këtë çështje me seriozitet, pyjet janë në një gjendje të keqe dhe janë duke u dëmtuar, u shpreh Tahiri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për riemërtimin e rrugës “Hasan Tiku Shabani” në emrin e rrugës së propozuar “Dëshmorët e Oshlanit” në Vushtrri.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – i njoftoi të pranishmit se kjo rrugë gjendet afër lumit “Podrança” dhe se banorët që jetojnë në këtë rrugë përmes peticionit (mbi 50%) kanë kërkuar riemërtimin e rrugës nga “Hasan Tiku Shabani” në “Dëshmorët e Oshlanit”, kurse rruga “Hasan Tiku Shabani” shkon në listën rezervë të rrugëve. Banorët që jetojnë në këtë rrugë janë kryesisht nga fshati Oshlan, tha ai.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – iu kisha sugjeruar që të keni kujdes tek ndryshimi i emrave të rrugëve, sepse është çështje e ndjeshme, si dhe mos të bëhen këto çështje për inate politike, pasi që krijohet një precedent. Sipas meje, kjo është një tendencë për heqjen e këtij emri, sepse dikujt i pengon. Prandaj, e thashë që duhet me pasur kujdes tek ndryshimi i emrave, sepse sipas legjislacionit në fuqi nuk është edhe aq lehtë ndryshimi i emrave.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se tek renditja e listave rezervë, ndryshimi i rrugëve shkon sipas radhitjes nga fillimi i emrave që gjenden në listë, të cilat janë votuar në kuvend, e jo sipas “tekeve” të dikujt që të merret emri i rrugës që është psh. në fund dhe të del i pari.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se lista rezervë posedon rreth 200 emra të rrugëve, kurse shumica e emrave të kësaj liste rezervë janë shfrytëzuar dhe se ka pasur kërkesa edhe në qeverisjen e kaluar .

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – pyeti se a janë analizuar kriteret dhe a janë bërë në harmoni me legjislacionin në fuqi?

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – u shpreh se kriteret janë respektuar dhe janë në harmoni me legjislacionin.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se ka qenë pjesë e komisionit për shqyrtim të ankesave lidhur me çështjen e emërimit të rrugëve. Sipas tij, qysh në fillim është bërë lëshim në këtë çështje, sepse në drejtori nuk ekzistojnë procesverbale lidhur me mbajtjen e takimeve, tha ai. Prandaj, përderisa nuk gjenden procesverbalet e takimeve dhe nuk janë pyetur qytetarë për këtë, po del që një grup i ngushtë i njerëzve ka vendosur për vendosjen e disa emrave të rrugëve, theksoi Feka.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore – deklaroi se sipas udhëzimit administrativ 14/12 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal të adresave, është kusht esencial që iniciimi i procedurës për riemërtimin e një rrugë (që e ka pasur një emër dhe dëshirojmë ta ndërrojmë) duhet të jetë 50% e petitionit të nënshkruar nga banorët që banojnë në atë rrugë. Konsideroj që duhet të bëhet një shënim zyrtar dhe të konstatohet gjendja reale lidhur me numrin e banorëve të asaj rruge. Pajtohem edhe unë që duhet të ketë kujdes tek ndryshimi i emrave të rrugëve, pasi që është çështje e ndjeshme.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se vendimin për këtë çështje e merr kuvendi dhe jo drejtorja. Drejtori e ka sjell propozim-vendimi, kurse kuvendi është ai që vendos, tha Tahiri. Ai tha se si qeveri komunale jemi të gatshëm që bashkë me kuvendin të deklarohejmë që mos ta prekim asnjë ndryshim të asnjë rruge deri në fund të vitit dhe pastaj mund ta formojmë një komision dhe të shikojmë rast pas rasti edhe me anëtarë të kuvendit dhe të verifikimit të nënshkrimeve, theksoi ai. Ndërkaq, lidhur me verifikimin e nënshkrimeve të petitionit, Tahiri tha se nëse dikush ka dorëzuar dokument të pavërtetë me të cilin ka mashtruar komunën, me këtë ka kryer vepër penale dhe përgjegjësinë e mbanë ai që e ka sjellë dokumentin. Edhe unë pajtohem që kjo çështje është e ndjeshme dhe nëse e fillojmë këtë çështje do të na krijohen shumë telashe, tha ai.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha që është lehtë të paraqitesh se nuk ka ndodhur asgjë dhe është lehtë të thuhet se kam qenë pjesë e atij komisioni e me u paraqit viktimitë. Zhegrova tha se komisioni për emërim të rrugëve ka pasur rreth 20 anëtarë dhe anëtar i atij komisioni kam qenë edhe unë. Sipas Zhegrovës, tek emërimet e rrugëve, parimisht jemi dakorduar që rrugët, të cilat janë në qytet mos të preken, pasi që kanë pasur emrat e dëshmorëve të luftës së fundit dhe të luftërave të kaluar. Nëpër lagje dhe nëpër fshatra janë mbajtur takime, ku personalisht kam qenë në disa takime, ku ka pasur ankesa, kurse në disa raste kanë shkuar edhe në votime. Mirëpo, ligji e thotë qartë, që për emërim të rrugëve, primare janë dëshmorët, pastaj vijnë kontribuuesit tjerë dhe në asnjë rast nuk kemi bërë dallime, theksoi Zhegrova.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se unë kam qenë anëtar i komisionit për ankesa, jo anëtar i komisionit për emërim të rrugëve.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – tha që mos të krijojmë precedent, pasi që mund të kërkoj ndonjë lagje ndryshimin e emrave. Sipas Bilallit, duhet të kemi kujdes tek aspekti ligjor.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se duhet të kemi kujdes, sepse e njëjta gjë mund të na ndodhë edhe me emrat e shkollave. Psh, shkolla që unë punoj tash quhet “Bahri Haxha”, kurse në flagrancë i është hequr emri “Latif Berisha”, kur ka emra të shkollave në qytet që ende nuk kanë emra, tha ai.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri kërkoi që të analizohet gjendja në terren se sa është numri i banorëve që banojnë në këtë rrugë, po ashtu të verifikohen nënshkrimet e banorëve të nënshkruar në petition. Me këto plotësime të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për renditjen në <listën e emrave rezervë të rrugëve>, emrat e propozuar si në vijim: “Liman Bajram Hasani”, “Haradin Liman Hasani”, “Selman Liman Hasani”, “Ali Jakupi” dhe “Enver Morina”.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në propozim-vendim po thuhet që “Enver Morina” të futet në listën e emrave rezervë të rrugëve, derisa me petition është kërkuar ndryshimi i emrit të rrugës “Komanda e UÇK-së”, që parashtuesi i kërkesës që qenka kandidat për doktoraturë e ka bërë një kërkesë me shumë gabime drejtshkrimore. Ndërsa, tek rasti i familjes “Hasani” në Stroc, kemi të bëjmë me një rast familjar (babai me dy djem).

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se kemi arritur kompromis me banorët e kësaj rruge që jo të hiqet emri “Komanda e UÇK-së”, por emri i propozuar të futet në listën rezervë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr. 49/17 të datës 23.02.2017.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë- sqaroi se anëtari i komisionit Isa Hajrizi nuk është më anëtar i kuvendit dhe rrjedhimisht nuk mund të jetë anëtar i komisionit. Prandaj, kemi kërkuar që të plotësohet komisioni edhe me një anëtar dhe të vazhdoj punën e tij.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

- a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelim të parkut industrial në fshatin Lumadh.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se është obligim ligjor themelimi i parkut industrial. Ai tha se proceduralisht, në momentin që licencohet zona ekonomike duhet të merret vendimi për themelim të saj.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – pyeti se me çfarë kriteresh do të vendosen bizneset në zonën ekonomike në fshatin Lumadh? A do të ketë bartje të bizneseve, apo do të ketë biznese të reja?

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – sqaroi se Ligji për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimi Administrativ për këtë fushë i parasheh procedurat dhe kriteret për vendosjen në zonën ekonomike.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se hapi i parë është aspekti ligjor që tani veç po e përfundojmë. Hapi tjetër është punimet në këtë zonë. Në momentin që përfundojmë punimet në ndonjë pjesë, psh mund të shpallet për 5 hektarë, tha ai. Para se të shpallen procedurat, kuvendi do ta themelojë një komision.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se është një gjë e mirë se do të ndodhë parku i biznesit. Mirëpo, ai tha se fatkeqësi është hapësira e vogël, pasi që nuk do të zë biznese aq shumë sa ne do të mendojmë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

b. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Ismail Istrefi.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – si kryesues i kuvendit jam në një pozicion të palakmueshëm dhe jo i barabartë në trajtimin e kërkesave për ndihmë financiare, pasi që disa raste më herët i kemi kthyer për shqyrtim në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Prandaj, duhet të shikohen rastet tjera se si kanë përfunduar dhe se a iu ka kthyer përgjigje komisioni i drejtorisë, tha Aliu.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se buxheti për këtë kategori është 16,500.00€ dhe është shumë i vogël që t’iu ndihmohet të gjitha rasteve që kanë nevojë. Kurse, kryetari i komunës ka të drejtë deri në 500€ t’i ndihmoj rastet, në bazë të rekomandimit të komisionit. Ai sugjeroi që asnjë rast mos të kalojë shumën mbi 1000€, për shkak të buxhetit të limituar në këtë kategori, por kuvendi është që vendos për këtë çështje.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se le të vjen propozim-vendimi nga për Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në bazë të kërkesës së palës.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ta hartojë një Propozim-vendim dhe të caktohet shuma financiare në bazë të kërkesës së palës dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – deklaroi se ky propozim-vendim ka ardhur vetëm për mirënjohje. Kurse, s'po e shoh që ka ardhur propozimi për titullin “Nderi i qytetit”. Lidhur me këtë, disa qytetarë kanë dorëzuar një petition për shpalljen e Naser Imerit- “Nderi i qytetit”. Me këtë petition, qytetarët u janë drejtuar, Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës, KPF-së, komisionit, tha Zhegrova., i cili shtoi se është mirë të vjen në kuvend ky petition që ta shqyrtojmë.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – deklaroi se nuk ka pranuar asnjë petition nga ana e qytetarëve.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – propozoi Naser Imerin për titullin “Nderi i qytetit”, duke u bazuar edhe në petitionin që është inicuar për këtë çështje.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – propozoi Ali Januzin për titullin “Nderi i qytetit”.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – propozoi Emin Selacin për titullin “Nderi i qytetit”.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – deklaroi se ka disa kohë që titulli “Nderi i qytetit” u është dhënë njerëzve që janë në përfundim të karrierës, e jo njerëzve që janë krejt aktiv tash.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se ka qenë praktikë që lidhur me propozimet për mirënjohje që jepen për “Ditën e Çlirimit” të konsultohen edhe organizatat e dala nga lufta. Përveç që janë konsultuar këto organizata, përfaqësuesit e tyre kanë qenë të përfshirë në komision, tha Klinaku. Këtu po thuhet që veteranët kanë marrë mirënjohje, unë po iu them që ka shumë veteranë që nuk kanë marrë mirënjohje. Rast konkret është Ilmi (Hysni) Saraçi, i cili nuk ka marrë mirënjohje dhe ka qenë pjesëmarrës në tri luftëra: Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Ushtrinë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc dhe në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare të Maqedonisë.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – deklaroi se jemi konsultuar me organizatat e dala nga lufta dhe shoqatat tjera dhe propozimet që i kanë dhënë ata kanë qenë në listë që u janë dhënë më herët mirënjohje.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e KPF-së – tha se duhet të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për dhëniet e mirënjohjeve dhe dekoratave. Nëse dikush ka marrë mirënjohje, ka të drejtë të merr plaketë, tha ajo.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha se e kemi pasur një rast para dy viteve që është lënduar, pasi që nuk ka fituar në kuvend, sepse ai që propozohet nëse nuk fiton , normal që lëndohet. Shumicën e kërkesave që janë dhënë nga shoqatat e dala nga lufta i kemi përfshirë. Prandaj, është mirë ta gjejmë një gjuhë të përbashkët dhe t'i ftoni përfaqësuesit e subjekteve politike që të koordinohemi.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që Komisioni për Dekorata ta plotësojë këtë propozim-vendim dhe t'i përfshijë propozimet


e KPF-së dhe ta procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

Të ndryshme.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se duhet të krijohet një standard i njëjtë për hartimin e shkresave nga qeveria komunale. Kjo për shkak se, para vetes kam tri informata nga tri drejtori të ndryshme dhe asnjëra nuk e ka standardin e njëjtë.


Mbledhja përfundoi në orën **15:40**

Bujar Klinaku



Procesmbajtës



 **Nasuf Aliu**

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së